



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
KOSOVA CHAMBER OF ADVOCATES
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA**

RREGULLORE

**mbi themelimin, organizimin dhe funksionimin e Shoqërive të Avokatëve,
Zyrave të Përbashkëta të Avokatëve dhe bashkëpunimin/lidhjen e zyrave të
avokatëve, Shoqërive të Avokatëve dhe Zyrave të Përbashkëta të Avokatëve**

**P r i s h t i n ë
29 tetor 2011**

Në bazë të nenit 31, 33, dhe 39 të Ligjit për Avokatinë Nr. 03/L-117 të Republikës së Kosovës, Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës me datë 29 tetor 2011 nxjerrë këtë

RREGULLORE

Mbi themelimin, organizimin dhe funksionimin e Shoqërive të Avokatëve, Zyrave të Përbashkëta të Avokatëve dhe bashkëpunimin/lidhjen e zyrave të avokatëve, Shoqërive të Avokatëve dhe Zyrave të Përbashkëta të Avokatëve

I. SHOQËRITË E AVOKATËVE

Neni 1

- 1.1. Dy ose më tepër avokatë të regjistruar në regjistrin e Odës së Avokatëve mund të themelojnë një zyrë avokatie me cilësi të personit juridik (Shoqëritë e Avokatëve);
- 1.2. Shoqëritë e Avokatëve, si persona juridikë, themelohen në përputhje me dispozitat ligjore mbi shoqëritë tregtare;
- 1.3. Anëtar i Shoqërisë mund të jetë vetëm avokati i regjistruar në regjistrin e Odës së Avokatëve;
- 1.4. Një avokat mund të jetë anëtarë vetëm në një shoqëri të avokatëve në territorin e Republikës së Kosovës;
- 1.5. Kryerja e veprimtarisë në kuadër të Shoqërisë së Avokatëve mund t'iu besohet anëtarëve të shoqërisë së avokatëve, juristëve të punësuar në shoqërinë e avokatëve ose praktikantëve në shoqëri të avokatëve;
- 1.6. Me marrëveshjen me shkrim për themelimin e shoqërisë duhet të rregullohen të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të shoqërisë, respektivisht të anëtarëve të tjerë të shoqërisë në rast të vdekjes të ndonjërit të anëtarëve të shoqërisë si dhe të drejtat e trashëgimtarëve të anëtarit të vdekur të shoqërisë;
- 1.7. Në shoqëri mund të ketë avokat që punojnë por nuk janë anëtarë të shoqërisë. Statusi i tyre është si të punësuar në shoqëri apo si bashkëpunëtorë të jashtëm, me kontratë;
- 1.8. Shoqëria e avokatëve mund të angazhojë bashkëpunëtor të jashtëm, specialist të fushave të caktuara juridike, për raste të caktuara, me qëllim të dhënies së ndihmës juridike për klientët;
- 1.9. Me aktet e përgjithshme të shoqërisë (marrëveshjen mbi themelimin apo ndonjë akt tjetër) nuk duhet të vihen në pyetje pavarësia e avokatëve në ushtrimin e avokatisë;
- 1.10. Avokati që punon në shoqëri është i obliguar të ofroj atë lloj të shërbimeve juridike të cilat ia përcakton shoqëria, nëse me marrëveshjen e lidhur mes shoqërisë dhe avokatit nuk është përcaktuar ndryshe;

Neni 2

- 2.1. Për themelimin e shoqërisë së avokatëve, avokatët themelues janë të obliguar që të marrin pëlqimin e Bordit Drejtues të OAK, i cili vlerëson se a është marrëveshja për themelimin e shoqërisë në përputhje me ligjin, Statutin dhe aktet tjera të përgjithshme të Odës dhe të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit.
- 2.2. Kërkesës për thënien e pëlqimit paraprak duhet ti bashkëngjitet edhe një kopje origjinale e marrëveshjes mbi themelimin e shoqërisë;
- 2.3. Lidhur me këtë kërkesë, Këshilli ekzekutiv vendos në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të sajë në Odë;
- 2.4. Shpenzimet e procedurës për dhënien e pëlqimit paraprak i bartë parashtruesi i kërkesës;
- 2.5. Pas regjistrimit, Shoqëria e avokatëve është e obliguar të njoftoj Odën për regjistrimin e sajë në regjistrin përkatës, më së voni **8 ditë** nga dita e marrjes së Certifikatës për regjistrim në Regjistrë;
- 2.6. Oda ka për obligim që shoqërinë e themeluar të avokatëve ta regjistrojë në Regjistrin e Odës të shoqërive të avokateve më së voni **8 ditë** nga dita e marrjes së njoftimit se shoqëria është regjistruar si shoqëri avokatesh në Zyrën për regjistrimin pranë Ministrisë përkatëse.
- 2.7. Shoqëritë e avokatëve ofrojnë shërbimet juridike si shoqëri me regjistrimin në Regjistrin e OAK për shoqëritë e avokatëve.

THEMELIMI DHE REGJISTRIMI I SHOQËRISË SË AVOKATËVE

Neni 3

- 3.1. Shoqëria e avokatëve themelohet konform nenit 33 të Ligjit për shoqëritë tregtare, dhe vepron si me shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Në emrin zyrtarë të shoqërisë duhet të përfshihet shkurtesa sh.p.k..
- 3.3. Shoqëria e Avokatëve themelohet me marrëveshje konform nenit 86 të Ligjit për shoqëritë tregtare të cilën e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e shoqërisë të cilët janë njëkohësisht pronarë.
- 3.4. Statuti i shoqërisë përmban njëkohësisht të gjitha dispozitat të parapara me nenin 33 lidhur me nenin 85 të Ligjit për shoqëritë tregtare.
- 3.5. Nëse Oda konstaton se veprimtaria e shoqërisë së avokatëve, me marrëveshje të lidhura mes shoqërisë së avokatëve dhe anëtarëve të sajë si dhe të kushteve sipas të cilave avokatët zhvillojnë veprimtarinë e tyre shkelin dispozitat e Ligjit, Statutit të Odës apo Kodit të etikës profesionale të avokatit, ndalon veprimtarinë e shoqërisë dhe e bene shlyerjen nga Regjistri i shoqërive të avokateve të Odës. Kundër vendimit për ndalimin e punës së shoqërisë së avokatëve mund të iniciohet kontest administrativ;
- 3.6. Mbi ndalimin e punës së shoqërisë së Avokatëve, njoftohet ARBK
- 3.7. Në bazë të aktvendimit të plotfuqishëm të Odës për shlyerjen e shoqërisë së avokateve nga regjistri i shoqërive të avokateve, Oda në bashkëpunim me gjykatën kompetente dhe me Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve do të fillojë procedurën e likuidimit të rregullt të shoqërisë së avokateve apo të falimentimit.
- 3.8. Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë do të përmbillet konform nenit 117, 118 lidhur me nenin 229 dhe 230 të Ligjit për shoqëritë tregtare, dhe në rastet tjera të parapara me Statutin e Odës së Avokatëve të Kosovës, Kodit të etikës profesionale të avokatit dhe Ligjit për avokatinë të Republikës së Kosovës.

Neni 4

- 4.1. Për ofrimin e ndihmës juridike palëve avokatët në shoqërinë e avokatëve janë përgjegjës sipas rregullave të përgjithshme të përgjegjësisë profesionale. Anëtarët e shoqërisë së avokatëve solidarisht janë përgjegjës për detyrimet e shoqërisë dhe të avokatëve të cilët punojnë në shoqëri dhe ofrojnë ndihmë juridike dhe të cilat detyrime lindin lidhur me ofrimin e kësaj ndihme;
- 4.2. Lidhur me detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë, përgjegjësisë disiplinore dhe raportin me Odën dhe organet e sajë, avokatët në shoqërinë e avokateve i kanë të drejtat dhe detyrimet e njëjta si avokatet që kanë zyrat e tyre personale;
- 4.3. Shoqëritë e avokateve kane te drejte qe ne territorin e Republikës se Kosovës te hapin përfaqësitë e veta në të cilën do të punësohen vetëm avokatët të cilët janë anëtarë të OAK.

Neni 5

Oda mban një regjistër të veçantë të shoqërive të avokateve;

Neni 6

- 6.1. Shoqëritë e avokatëve edhe me rastin e regjistrimit në Odë mundë të përcaktohen për ofrimin e ndihmës juridike në një apo më shumë fusha të caktuar të së drejtës;
- 6.2. Shoqëria e avokatëve mund të kërkojë nga Oda që ti pranohet specializimi i sajë në fusha të caktuara të së drejtës;
- 6.3. Shoqërisë së avokatëve do ti pranohet specializimi nëse më së paku një prej avokatëve, anëtarë të shoqërisë apo avokat që punon në shoqëri specializimi tanimë i është pranuar në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Avokatin dhe të Statutit të Odës.
- 6.4. Në këtë rast specializimi i shoqërisë figuron në emërtimin e sajë.

II. ZYRAT E PËRBASHKËTA TË AVOKATËVE

Neni 7

- 7.1. Dy ose më tepër avokatë, të regjistruar në Regjistrin e avokatëve të Odës mund të themelojnë një zyrë të përbashkët. Zyra e përbashkët themelohet me Marrëveshje, në të cilin përcaktohen detyrimet reciproke të avokatëve të zyrës së përbashkët;
- 7.2. Marrëveshja e zyrës duhet t'i dërgohet Odës së Avokatëve për regjistrim. Zyra mund të ketë vetëm një seli dhe vepron vetëm pas regjistrimit në regjistrin e Odës së Avokatëve;
- 7.3. Pas regjistrimit në Regjistrin e Odës për zyrat e përbashkëta të avokatëve, zyra e përbashkët e avokatëve do të regjistrohet në autoritetin përkatës, si ortaki e përgjithshme;
- 7.4. Zyra e përbashkët e avokatëve do ta njoftoj Odën se është regjistruar konform nenit 7.3 te kësaj rregulloreje në afat prej 8 ditësh, pasi që ky regjistrim të jetë bërë;
- 7.5. Avokatët e zyrës së përbashkët mund të zëvendësohen reciprokisht në përfaqësimin e klientëve, me pëlqimin e klientëve.
- 7.6. Avokatët e bashkuar në zyrë të përbashkët mbajnë përgjegjësi të përbashkët për obligimet të cilat rrjedhin nga zyra. E njëjta gjë vlen edhe për përgjegjësinë për të punësuarit në zyrën e përbashkët.

7.7. Përgjegjësia profesionale dhe personale mbetet përgjegjësi individuale e avokatëve të zyrës..

7.8. Shpërbërja e zyrës së përbashkët të avokatëve me ç'rast shuhet dhe likuidohet dhe pushon së vepruari zyra e përbashkët e avokatëve bëhet konform Ligjit për shoqëri tregtare dhe dispozitave të kësaj rregullore të përcaktuara për shpërbërjen dhe likuidimin e shoqërisë së avokatëve.

Neni 8

Oda mban një regjistër të veçante të zyrave të përbashkëta të avokatëve.

III. BASHKËPUNIMI/LIDHJA E ZYRAVE TË AVOKATËVE, ZYRAVE TË PËRBASHKËTA TË AVOKATËVE DHE SHOQËRIVE TË AVOKATËVE

Neni 9

9.1. Zyra e avokatit, zyrat e përbashkëta të avokatëve dhe shoqëritë e avokatëve mundën që me marrëveshje në formë të shkruar të lidhen/bashkëpunojnë me zyra të tjera të avokatëve, zyra të përbashkëta të avokatëve apo të shoqërive të avokatëve të vendit dhe të huaja me qëllim të kryerjes së punëve të caktuara me interes të përbashkët, ofrimin e ndihmës reciproke etj.;

9.2. Një kopje të kësaj marrëveshje zyrat e avokatëve, zyrat e përbashkëta të avokatëve apo shoqëritë e avokatëve, menjëherë duhet të ia prezantojnë Odës së Avokatëve;

9.3. Oda është e autorizuar që ti tërheq vërejtjen zyrës së avokatëve, zyrës së përbashkët të avokatëve apo shoqërisë së avokatëve lidhur me të metat e vërejtura apo mospërputhjes së marrëveshjes me Ligjin, Statutin e Odës apo Kodin e etikës Profesionale.

Neni 10

10.1. Zyra e avokatit, zyrat e përbashkëta të avokatëve dhe shoqëritë e avokatëve mund të lidhen/bashkëpunojnë me zyrat e tjera vendore apo ndërkombëtare me qëllim të kryerjes së punëve të caktuara për interes të përbashkët, afrimin e ndihmës së ndërsjellë në të gjitha apo në disa çështje juridike, veçanërisht në besimin e zëvendësimit në përfaqësim, me qëllim të mbledhjes së të dhënave, përpilimin e mendimeve ligjore, pranimin për ushtrimin e praktikës të avokatëve dhe praktikantëve të avokatëve etj.;

10.2. Vendosja e bashkëpunimit behet me marrëveshje të përbashkëta për lidhje/bashkëpunim,

10.3. Marrëveshjet për lidhje/bashkëpunim duhet të bazohen në parimin e barazisë dhe të besimit të ndërsjellë dhe me to zyrat e caktuara të avokatëve, zyrat e përbashkëta të avokatëve apo shoqëritë e avokatëve nuk guxojnë të vihen në pozitë të nënshtrimit. Nuk konsiderohet se një zyrë, zyrë e përbashkët e avokatëve apo një shoqëri e avokatëve është vënë në pozitë nënshtruese vetëm nga fakti se ka marrë obligimin e njëanshëm për ofrimin e shërbimeve juridike të llojit të caktuar një zyre tjetër, zyre të përbashkët tjetër apo shoqërie tjetër të avokatëve;

10.4. Me Marrëveshjen për lidhjen/bashkëpunimin e zyrave të avokatëve, zyrave të përbashkëta të avokatëve apo shoqërive të avokatëve mund pajtohen që do të ofrojnë shërbime të caktuara juridike ekskluzivisht në një fushë të caktuar. Me këtë

lloj marrëveshje nuk mund të kufizohet e drejta për ofrimin e shërbimeve të caktuara zyra të tjera të avokatëve, zyra të tjera të përbashkëta të avokatëve apo shoqërive të tjera të avokatëve respektivisht personave të tjerë fizik dhe juridik, jashtë kufizimeve të përcaktuara me Kodin e Etikës Profesionale;

10.5. Në emrin e sajë, vulë dhe në memorandum zyrat e avokatëve, zyrat e përbashkëta të avokatëve apo shoqëritë e avokatëve mund të shënojnë emrat e zyra të avokatëve, zyra të përbashkëta të avokatëve apo të shoqërive të avokateve me të cilat kanë marrëveshje bashkëpunimi.

10.6. Marrëveshja e lidhjes/bashkëpunimit duhet të lidhet për ofrimin e shërbimeve të vërteta të ndërsjella e nuk guxon të jetë formë për arritjen e qëllimeve tjera reklamuese;

10.7. Kundër Vendimit me të cilin Bordi Drejtues i OAK refuzon regjistrimin e marrëveshjes së lidhjes/bashkëpunimit në Regjistrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit/lidhjes të zyra të avokatëve Këshilli Ekzekutiv palët e interesuara kanë të drejtë ankese Komisionit të Kuvendit për shqyrtimin e ankesave të Odës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Kundër vendimit përfundimtarë pala e pakënaqur mund të iniciojë konfliktin administrativë .

Bordi Drejtues edhe pa shqyrtimin e përputhshmërisë së marrëveshjes të lidhjes/bashkëpunimit mes zyra të avokatëve, zyra të përbashkëta të avokatëve apo shoqërive të avokatëve vendor dhe atyre të jashtëm, respektivisht të shoqërive të jashtme të avokatëve me ligjin, Statutin dhe Kodin e Etikës Profesionale, do të refuzojë regjistrimin e marrëveshjes në Regjistrin përkatës të Odës nëse bëhet fjalë për palë kontraktuese nga jashtë për të cilën tanimë ekzistojnë të dhëna që me veprimet e saja ka treguar mosrespektim të rendit juridik të Republikës së Kosovës

Neni 11

11.1. Me qëllim të shqyrtimit të marrëveshjes për themelimin e shoqërisë së avokatëve, marrëveshjes për themelimin e zyrës së përbashkët të avokatëve dhe të marrëveshjes për lidhjen/bashkëpunimin e zyra të avokatëve, si dhe me qëllim të zbatimit të kontrollit të zbatimit të këtyre marrëveshjeve, Bordi Drejtues do të caktojë grupe profesionale për raste të veçanta e për këtë qëllim gjithashtu mund të sigurojë mendime juridike të ekspertëve jashtë Odës.

11.2. Avokati në zyrën e avokatit, zyrën e përbashkët të avokatëve apo në shoqërinë e avokatëve ka për obligim që me kërkesën e grupit profesional të ju mundësojnë qasje të lirë në burimet relevante të të dhënave me qëllim të shqyrtimit të marrëveshjes dhe zbatimit të kontrollit;

11.3. Pas pranimit të raportit të grupit profesional mbi shqyrtimin e marrëveshjes mbi lidhjen/bashkëpunimin të zyra të avokatëve, zyra të përbashkëta të avokatëve apo të shoqërive të avokatëve si dhe të zbatimit të mbikëqyrjes për zbatimin e këtyre marrëveshjeve, Bordi Drejtues do të shlyej regjistrimin e marrëveshjes për lidhje/bashkëpunim nga regjistrat gjegjësisht nga të njëjtat shkaqe nga të cilat mund edhe të refuzojë regjistrimin e marrëveshjes për lidhjen/bashkëpunimin, ti urdhërojë avokatit, zyrës së përbashkët të avokatëve apo shoqërisë së avokatëve , që të shkëputë marrëveshjen me palën tjetër kontraktuese dhe provën për këtë shkëputje të ia prezantoj Bordit

11.4. Pala e interesuar ka të drejtë ankese si në rastin e refuzimit të regjistrimit të marrëveshjes për lidhje/bashkëpunim në Regjistrin e Odës.

Neni 12

12.1. Oda mban një regjistër të veçan të marrëveshjeve të bashkëpunimit të zyrave të avokatëve, zyrave të përbashkëta të avokatëve apo të shoqërive të avokatëve;

12.2. Regjistri i Odës mbi lidhjen bashkëpunimin përmban shënimet si më poshtë:

- a) shënimet mbi zyrat e avokatëve, zyrat e përbashkëta të avokatëve apo të shoqërive të avokatëve të cilat e kanë lidhur marrëveshjen,
- b) vendi dhe data e lidhjes së marrëveshjes së bashku me shënimet mbi plotësimet dhe ndryshimet e mëvonshme;
- c) shënimi i shkurtër mbi përmbajtjen dhe formën e bashkëpunimit dhe
- d) data e regjistrimit , data dhe numri i vendimit.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 13

Të gjitha zyrat e përbashkëta të avokatëve të cilat janë të regjistruara në Regjistrin e zyrave të përbashkëta të Odës së Avokatëve të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, do ta plotësojnë dokumentacionin e tyre të depozituar në Odë, me rastin e regjistrimit, në përputhje me nenin 7 të kësaj rregulloreje.

Neni 14

Në të gjitha rastet kur dy e më tepër avokat, në praktike, kanë vepruar si shoqëri e avokatëve dhe si të tilla kanë qenë të Regjistruara në Agjencinë për regjistrimin e bizneseve në Kosovë, në afat prej 30 ditësh, nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, janë të obliguar që të parashetrojnë në Odë kërkesën për regjistrim të shoqërisë të avokatëve, në përputhje me nenin 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 15

Te gjitha zyrat e avokatëve dhe zyrat e përbashkëta të avokatëve të cilat në vulat e tyre, memorandumet apo në web faqe kanë prezantuar të dhëna për bashkëpunimin/lidhjen e zyrave të tyre me zyra të tjera vendore apo ndërkombëtare, me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore janë të obliguar që këto të dhëna ti mënjanojnë, përderisa një marrëveshje për bashkëpunimin/lidhjen e këtyre zyrave të mos jetë regjistruar në regjistrin e Odës në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 16

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit në Kuvendin e Odës së Avokateve të Kosovës, me datë 29.10.2011.

Prishtinë, datë: 29.10.2011

Kryetari
E ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS
Ibrahim Dobruna,